

## KONTRATE



### **PER THEMELIMIN E SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

### **“ NARI-LUNDRA ” Sh.p.k.**

#### Midis Shtetasve:

1. **Eriola GIDAJA** , e bija e Agronit , e dtl. 1984, lindur ne Tirane dhe banuese ne Mullet te Tiranës . Madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , me dokument identifikimi (pasaport) Nr. Z1261970 . Shtetase shqiptare .
2. **Ardian Tufa** , i biri i Isufit , i dtl.1971, lindur dhe banues ne Lunder te Tiranës , . Madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , me dokument identifikimi (pasaport) Nr. Z1675484 . Shtetas shqiptar .

Te dy madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne baze te legjislacionit shqiptar kane vendosur me vullnetin e tyre te lire dhe te plote , te arrijne marreveshjen per themelimin e shoqerise tregetare private, me pergjegjesi te kufizuar, te emertuar “ **NARI - LUNDRA “ Sh.p.k.** e cila do te rregullohet ne mbeshtetje te ligjes Nr. 7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private , nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit " te ligjes 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare " , ligjes 7667 date 28.01.1993 " Per rregjistrin Tregetar " , si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe normave qe vijojne :

#### Neni 1

Te themelojne nje shoqeri tregetare me pergjegjesi te kufizuar e quajtur “**NARI - LUNDRA “ Sh.p.k.**

**NARI - LUNDRA Sh.p.k.** eshte nje subjekt juridik Shqiptar, te cilit i lind e drejta te ushtroje aktivitetin qe nga data e rregjistrimit ne Rregjistrin tregetar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Shoqeria **NARI - LUNDRA** zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me aktet e themelimit te saj.

#### Neni 2

Shoqeria do te jete e formes se Shoqerive tregetare me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbjet deri ne kufirin e vleres te kontributit te derdhur ne kapitalin themelor.

#### Neni 3

Objekti i aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete:

- Import – eksport , tregetin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve , me shumice dhe pakice si :
- Tregetim artikuj te ndryshem industriale .

- Tregetim artikuj te ndryshem ushqimore .
- Tregetim artikuj te ndryshem bujqesore e blegtorale .
- Tregetim fruta - perime .
- Tregetim automjetesh te cdo lloji , marke e tonazhi , si dhe pjese kembimi per to .
- Hapje pike lavazhi dhe servisi per lloje te ndryshme makinash .
- Tregetim paisjesh elektro - shtepiake , elektronike , elektrike , kompjuterike , higjieno , sanitare dhe hidraulike , prodhime qeramike , artizanati etj , kancelari , paisje zyrash .
- Hapje agjensi imobiliare .
- Hapje Agjensi Turisike .
- Hapje dhe shfrytezim hotelesh, motelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi e kurative .
- Sherbime televizive me kabell neper familje, internet .
- Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit .
- Transport personash brenda dhe jashte vendit .
- Tregetimin e materialeve te ndertimit e lendeve te para brenda dhe jashte vendit
- Tregetim bimesh medicinale e etero – vajore .
- Tregetim plehrash e prodhimesh te tjera kimike .
- Tregetim prodhimesh kozmetike e estetike .
- Tregetim prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi , dyer , dritare , etj.
- Tregetim lende drusore .
- Punime duralumini e tregetimin e tyre .
- Tregetimin e karburanteve te ndryshme me pakice, si dhe vajrave lubrifikante, te gazit te lengshem per ngrohje, paisje ngrohese gazi si dhe mbushjen e bombolave te gazit dhe tregetimin e tyre me pakice .

#### Neni 4

Shoqeria **NARI - LUNDRA** e ka seline e saj ne **Lunder te Tiranes** . Ajo ka te drejte te krijojë brenda dhe jashte teritorit te Republikës se Shqipërisë, filiale, agjensi perfaqesi, seli sekondare , dege ne menyre ambulatorë, me njesi apo duke hapur zyra ,si dhe ti suprimoje ato.

#### Neni 5


Kapitali themeltar i shoqerise **NARI - LUNDRA** eshte **100.000 leke** dhe eshte i perbere nga shuma ne te holla e derdhur nga ortakët.

#### Neni 6

Palet kontraktuese kane rene dakort te percaktojne kuoten e pjesemarrjes te seicilit ortak sime poshte:

**Eriola GIDAJA** ..... 20 % ( njezete )  
**Ardian TUFA** ..... 80 % ( tetedhjetë )

Percaktohet ketu se ortakët kane te drejte te kontrobuojne ne kuoten e tyre te pjesemarrjes,duke transferuar ne pronesi te shoqerise te mira meteriale.




### Neni 7

Kohezgjatja e shoqerise **NARI – LUNDRA Sh.p.k.** do te jete me afat te pacaktuar e mbi 10 vjete . Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te asamblese se ortakeve .

### Neni 8

I gjithe kapitali themelor eshte i ndare ne 100 pjese te barabarta ku sejcila pjese eshte e perbere nga 1000 leke .

I gjithe kapitali vene nga te dy ortaket themelues eshte teresisht dhe plotesisht I shlyeshtem dhe nenshkrueshem nga ana e tyre.

### Neni 9

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne shoqerine tregtare **NARI – LUNDRA** shenohet dhe kapitali i derdhur nga te dy ortaket . Rritja e kapitalit themelor te shoqerise nuk eshte e kufizuar .

### Neni 10

Te ardhurat e realizuara nga shoqeria do te ndahen pjeserisht ose totalisht ndermjet ortakeve sipas kuotave te tyre te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar ; pasi te jete lene nje shume menjane te pakten sa nje e njezeta e tij e cila destinohet per formimin e fondit rezerve.

### Neni 11

Ne kohen e prishjes se shoqerise ose te perfundimit te afatit , kur nuk ka zgjatje afati kapitali I shoqerise pasi te hiqen debitet e saj do te ndahet proporcionalisht ndermjet ortakeve sipas kuotave te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar .


### Neni 12

Fitimi I realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqerise , pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe ato qe kane lindur me te tretet , eshte plotesisht I transferueshem dhe per tu depozituar ne nje nga Bankat Shqiptare, ose per tu perdorur sipas nevojave te ortakeve te shoqerise

### Neni 13

Ortaket kane keto te drejta dhe detyra themelore:

- te derdhin kuoten kapitalit baze sikunder eshte percaktuar ne nenin 6,
- te marri pjese ne drejtimin e shoqerise,
- te terheqin fitimin e realizuar,
- te terheqin aktivin rezultatant nga bilanci i likujdimit ne rast te pushimit te aktivitetit te shoqerise,
- te ruajene sekretin e aktivitetit te shoqerise,
- te impenjohen per arritjen e objektivave te shoqerise.



#### Neni 14

Organet e shoqerise NARI - LUNDRA Sh.p.k. jane:

-Asamblea e Ortakeve te shoqerise .

-Administratori I shoqerise

Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre do te percaktohen ne statutin e shoqerise.

Administrator i shoqerise do te jete **Z. Ardian TUFA** .

#### Neni 15

Shoqeria tregtare private NARI - LUNDRA sh.p.k. eshte person juridik shqiptar dhe do te ushtroje veprimtarine e saj ekonomike private ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht ligjeve 7512 date 10.08.1991, 7638 date 19.11.1992, 7667 date 28.01.1993, te K. Civil si dhe te akteve ligjore dhe nenligjore te dala ne zbatim te tyre

#### Neni 16

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontartes se punes qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te ligjit 7961 date 12.07.1995 ( Kodi I Punes ) , si dhe akteve te tjera ne zbatim te tij .

#### Neni 17

Mosemarreveshjet e mundeshme qe mund te lindin gjate interpretimit apo zbatimit te kesaj kontrate palet do ti zgjidhin ne rruge miqesore ne te kundert kompetenca per zgjidhjen e konfliktit i kalon Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

#### Neni 18

Per sa nuk pershkruhet ne kete kontarte themelimi do te aplikohen nenet e statutit te shoqerise dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar .

#### Neni 19


Kjo kontrate eshte perpiluar ne kater kopje origjinale.

*Tirane, me 07.06.2006*

Eriola GIDAJA

Ardian TUFA

*Eriola Gidaja*  
*Ardian Tufo*



**STATUT**  
**I SHOQERISE TREGTETARE ME PERGJEGJESI TE**  
**KUFIZUAR**  
**“NARI-LUNDRA” SH.P.K.**

Shoqeria “ NARI - LUNDRA ” Sh.p.k. eshte e krijuar mbi bazen e kontrates midis dy ortakëve themelues te saj :

1. **Eriola GIDAJA** , e bija e Agronit , e dtl. 1984, lindur ne Tirane dhe banuese ne Mullet te Tiranes . Madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , me dokument identifikimi (pasaport) Nr. Z1261970 . Shtetase shqiptare .
2. **Ardian Tufa** , i biri i Isufit , i dtl.1971, lindur dhe banues ne Lunder te Tiranes, . Madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , me dokument identifikimi (pasaport) Nr. Z1675484 . Shtetas shqiptar .

Statuti eshte akti baze ku do te mbeshtetet themelimi i shoqerise tregtare private **NARI – LUNDRA Sh.p.k.** me pergjegjesi te kufizuar si dhe zhvillimi i metejshem i veprimtarise se saj .

Per te bere te mundur veprimtarine ekonomike dhe organizimin e kesaj shoqerie ne perputhje me ligjin 7512 date 10.08.1991 , 7638 date 19.11.1992, si dhe 7667 date 28.01.1993 eshte perpiluar ky statut me kerkesat e ligjes per shoqerite tregtare me pergjegjesi te kufizuar .

**Neni 1**

**EMERTIMI**

Shoqeria eshte quajtur **NARI - LUNDRA Sh.p.k.**

Ajo eshte nje subjekt juridik Shqiptar, te cilit i lind e drejte te ushtroje aktivitetin qe nga data e Rregjistrimit ne Rregjistrin tregtare prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Shoqeria **NARI – LUNDRA Sh.p.k** zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me aktet e themelimit te saj (kontrata dhe statuti).

**Neni 2**

**OBJEKTI**

Objekti i aktivitetit ekonomik te shoqerise **NARI – LUNDRA Sh.p.k** do te jete :

- Import – eksport , tregtimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve , me shumice dhe pakice si :
- Tregtim artikuj te ndryshem industriale .
- Tregtim artikuj te ndryshem ushqimore .
- Tregtim artikuj te ndryshem bujqesore e blegtorale .
- Tregtim fruta - perime .



- Tregetim automjetesh te cdo lloji , marke e tonazhi , si dhe pjese kembimi per to .
- Hapje pike lavazhi dhe servisi per lloje te ndryshme makinash .
- Tregetimin me shumice dhe pakice te mjeteve dhe paisjeve mjekesore, elektro-mjekesore .
- Import – Eksport, dhe tregetimin e artikujve te ndryshem mjekesore, medikamenteve te ndryshme , barnave te ndryshme mjekesore .
- Tregetim paisjesh elektro - shtepiake , elektronike , elektrike , kompjuterike , higjeno - sanitare dhe hidraulike , prodhime qeramike , artizanati etj , kancelari, paisje zyresh .
- Hapje agjensi imobiliare .
- Hapje Agjensi Turisike .
- Hapje dhe shfrytezim hotelesh, motelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi e kurative .
- Sherbime televizive me kabell neper familje, internet .
- Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit .
- Transport personash brenda dhe jashte vendit .
- Tregetimin e materialeve te ndertimit e lendeve te para brenda dhe jashte vendit
- Tregetim bimesh medicinale e etero – vajore .
- Tregetim plehrash e prodhimesh te tjera kimike .
- Tregetim prodhimesh kozmetike e estetike .
- Tregetim prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi , dyer , dritare , etj.
- Tregetim lende drusore .
- Punime duralumini e tregetimin e tyre .
- Tregetimin e karburanteve te ndryshme me pakice, si dhe vajrave lubrifikante, te gazit te lengshem per ngrohje, paisje ngrohese gazi si dhe mbushjen e bombolave te gazit dhe tregetimin e tyre me pakice .

### Neni 3

Per kryerien e veprimtarise se saj Shoqeria do te hapi njesi grumbulluese, perpunuese, sherbimi e tregetuese, si dhe do te bashkpusoj me persona fizike e juridike, vendas ose te huaj .

### Neni 4

#### SELIA

Shoqeria **NARI – LUNDRA** e ka seline e saj ne *Lunder te Tiranes*.

Ajo ka te drejte te krijoj brenda dhe jashte teritorit te Republikes se Shqiperise, filiale, agjensi perfaqesi, seli sekondare si dhe ti suprimoje ato.

Cdo ndryshim i selise do te behet me vendimin e asamblese se ortakeve te shoqerise .

### Neni 5

#### KOHEZGJATIA

Shoqeria do te kete nje kohezgjatie me nje afat te pacaktuar e mbi 10 vjet . Ajo mund te shperbeht ne cdo kohe me vendim te Asamblese se Ortakeve




## Neni 6

### KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100.000 leke** dhe eshte i perbere nga shuma ne te holla e derdhur nga ortaket.

## Neni 7

Palet kontraktuese kane rënë dakort te percaktojne kuoten e pjesemarrjes te seicilit ortak sime poshte:

**Eriola GIDAJA .....20% ( njezete )**  
**Ardian TUFA ..... 80 % ( tetedhjete )**

Percaktohet ketu se ortaket kane te drejte te kontrobuojne ne kuoten e tyre te pjesemarrjes,duke transferuar ne pronesi te shoqerise **NARI – LUNDRA Sh.p.k** te mira meteriale.

## Neni 8

I gjithë kapitali themeltar eshte i nfdare ne 100 pjese te barabarta ku sejcila pjese eshte e barabarte me nga 1000 leke .

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane teresisht dhe plotesisht te shlyeshme dhe te nenshkrueshme nga te dy ortaket themelues .

## Neni 9

Transferimi i kuotave behet vetem me akt noterial. Cdo transferim i kuotave tek te tretet i nenshtrohet te drejtes se parablerjes nga ortaku tjeter

Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve . Ortaku qe ka ndermend te cedoje kuotat e veta , perpara duhet ti komunikojte shoqerise projektin e transferimit . I takon ortakut tjeter te shoqerise te ushtroj te drejten e parablerjes . Nese shoqeria nuk jep pergjigje brenda nje muaji nga marria e projektit te transferimit , miratimi konsiderohet i dhene . nese ortaket duan te blejne, te ushtrojne te drejten e parablerjes, ata duhet te ushtrojne kete te drejte brenda nje muaji nga marria e projektit te transferimit . ne rast te kundert ata duhet te lejojne transferimin e kuotave te treteve .

Kushtet e ofruara te treteve nuk duhet te jene me te favoreshme nga ato te ofruara ortakeve .

Ne rast se lind nevoja per vlcesimin e kuotave, ortaket caktojne ekspert . Ne rast se nje gje e tille nuk arrihet prej tyre, caktimi i ekspertit behet nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane .

## Neni 10

Shoqeria mund te rrisi kapitalin themelor , ose mund ta zvogeloje ate , por gjithnje jo nen kufirin 100.000 leke, qe percaktohet ne ligjin 7638 date 19.11.1992 “ Per shoqerite tregtare “ me pergjegjesi te kufizuar .

shtimi ose pakesimi I kapitalit behet me vendim te Asamblese se ortakeve dhe sipas kerkesave te Ligjes .

### Neni 11

Pjeset e kapiatlit themelor jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie, ne rast ndarie pasurore ndermjet bashkeshorteve, paraardhesve e pasardhesve . ne rast vdekje te ortakut pjeset e kapitalit themelor qe disponon i kalojne trashegimtareve te tij, dhe kur asnjeri nga pjesetaret e familjes nuk pranon te punoje ne ortakeri, atehere u jepen te gjitha fitimet qe i takojne sipas kontributit te derdhur ne kapitalin themelor . Trashegimtari hyn ne shoqeri me te gjitha te drejtat e detyrimet perkatese te ortakut .

### Neni 12

Fitimi I realizuar nga ushtrimi I veprimtarise ekonomike I Shoqerise do te admionistrohet nga ortakut e shoqerise . Nje pjese e ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregetar . shoqeria eshte e detyruar te shlyeje te gjitha detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve .

### Neni 13

Shoqeria eshte disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj . Ajo mund te bleje e te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tretet .

Ne R.SH. NARI - LUNDRA Sh.p.k. gezon te drejta sikunder cdo person tjetet juridik ose fizik shqiptar ose I huaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi

### Neni 14

Shoqeria ka te hapur llogarine e saj rrjedhese ne Banke, nepermjet se ciles kryen veprime ekonomike financiare me partner te trete vendas dhe te huaj, duke likujduar me monedhe shqiptare apo te huaj, sipas marreveshieve te perfunduara midis tyre .

### Neni 15

Organet drejtuese te shoqerise jane :


Asambleja e ortakeve

Administratori I Shoqerise

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimor I shoqerise . Ajo mund te jete e zakoneshme ose e jashtezakoneshme . Asambleja e zakoneshme thirret te pakten dy here ne vit, pas mbylljes se vitit financiar, dhe kur aprovohet programi I veprimtarise per vitin e ardhshem .

Asambleja e jashtezakoneshme thirret kur administratori I shoqerise e quan te pershtateshme per kerkesat e shoqerise . I takon asamblese te jashtezakoneshme te beje , ndryshime ne Statutin e shoqerise, te pakesoj ose shtoj kapitalin themelor . Te shperndaj para afatit Shoqerine, ose te shtyje aktivitetin e saj.

### Neni 16





Asambleja e ortakeve drejtohet nga Administratori I shoqerise . I takon ketij te fundit te verifikoj rregullshmerine e pjesemarrjes se ortakeve . Cdo ortak mund te perfaqesohet ne Asamble nga nje tjetër ortak me ane te nje akti me delegim te nenshkruar sipas firmes se depozituar ne librin e ortakeve .

Per te mbajtur procesverbalin e mbledhjeve te Asamblese caktohet nje sekretar , qe mund te jete edhe nje noter . Vendimet e Asamblese duhet te nenshkruhen nga Administratori I Shoqerise, nga sekretari dhe nga te gjithë pjesemarrësit .

Vendimet e Asamblese te marra ne perputhje me ligjin dhe me kete statut jane te detyrueshme per te gjithë ortakët prezent ose jo .

#### Neni 17

Organi administrator i shoqerise eshte Administratori I shoqerise . Ai zgjidhet nga asambleja e ortakeve dhe qendron ne detyre per gjithë kohezgjaten e aktivitetit , pervec rasteve te nje revokimi eventual nga vet Asambleja e Shoqerise .

Administrator i shoqerise **NARI - LUNDRA Sh.p.k.** eshte **Z. Ardian TUF** .

#### Neni 18

Administratorit te shoqerise i takon administrimi i zakonshem i shoqerise pervecse kur kjo gje sipas ligjes apo Statutit i rezervohet Asamblese se Ortakeve .

I takon Administratorit te Shoqerise te perfaqesoj Shoqerine perpara te treteve dhe ne gjykim . Ai gezon te drejten e firmes se shoqerise .

Administratori mund ti delegoj te drejtat e veta nje personi te trete te autorizuar me shkrim per te perfaqesuar shoqerine si edhe te kryej veprime dhe praktika te ndryshme ne emer te tij .

#### Neni 19

Asambleja e ortakeve te shoqerise ka keto kompetenca, te marre keto vendime :


Te miratoj programin e veprimtarise se Shoqerise, te hartoj raportet e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore . Vendos per shperndarjen e shoqerise, per ndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve . Rregullon marrëdhëniet e punesimit dhe ato te shperblimit brenda shoqerise. Emeron dhe shkarkon administratore , eksperte kontabel . ben ndryshime e plotesime ne statut dhe ne kontarten e themelimit, vendos per rritjen ose zvogelimin e kapitalit themelor, kalimin e kapitalit te treteve, ndryshimin e kohes se veprimtarise, shnderrimin e shoqerise ne nje forme tjetër , likuidimin e shoqerise . Sipas akteve ligjore ben shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve shteterore , personave juridik ose fizike . vendas e te huaj .

#### Neni 20

Kontrolli financiar I shoqerise kryhet nga nje ose me shume ekspert kontabel te autorizuar ose te emeruar nga asambleja e ortakeve me nje afat prej tre vitesh financiare te njepasnjeshme me mundesi riemerimi .

#### Neni 21

Cdo vit financiar filln ne 1 janar te cdo viti dhe perfundon ne 31 dhejtor te cdo viti , me perjashtim te vitit te pare ku si fillim eshte data e rregjistrimit te shoqerise .



### Neni 22

Llogarite vjetore , inventaret , raporti mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret apo ekspertet kontabel miratohet nga asambleja e ortakeve . Miratimi I dokumnetave financiare vjetore behet brenda nje afati 3 - mujor, mbas dates se shlyerjes se vitit financiar .

### Neni 23

Mbas miratimit te llogarive vjetore dhe vertetimit te ekzistences se fitimit Asambleja e ortakeve vendos e krijon fondin ligjor, por mund te krijoje edhe fonde te tjera . Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se sigurimeve shoqerore etj. Ajo ka te drejte te celi llogari likujduese prane Bankave te vendit dhe te kryeje veprimtari likujduese nepermjet tyre .

### Neni 24

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbaron ne 31 dhjetor te cdo viti . Administratori ose personat e caktuar prej tij jane te detyruer te paraqesin bilancin vjetor dhe deklaraten e te ardhurave e ti depozitojne ne Organin financiar te Zyres se Tatimeve .

### Neni 25

Marredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen nepermjet kontartes se punesimit qe lidhet midis paleve ne perpouthje me ligjin 7961 date 12.07.1995 ( Kontrates se Punes ) si dhe legjislacionit tjeter shqiptar qe ben fjale per punesimin .

### Neni 26


Marrja ne pune behet me rregjistrimin nga punedhenesi ne librin e punes se shoqerise si dhe duke njoftuar organet e punes se juridiksionit ku ushtron veprimtarine shoqeria. Largimi nga puna ose ndryshimi I vendit te punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga administratori I shoqerise . Largimi lidhet me mbarimin e kontartes se punes, per shkelje disiplinore, ose edhe me vete kerkesen e te interesuarit . Largimi nga shoqeria behet pasi jane shlyer te gjitha detyrimet materiale e monetare .

### Neni 27

Shoqeria mund te lidhi kontrata me sektore shteterore drejtperdrejt ne tregun e lire si dhe me persona fizike ose juridike , vendas ose te huaj . Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqesohet nga administratori i shoqerise **Z. Ardian TUFA** . Ajo mund te perfaqesohet edhe nga persona te tjere te percaktuar prej saj me prokure . Te drejtat e detyrimet qe rrjedhin nga kontartat jane te detyrueshme per shoqerine .

### Neni 28

Shoqeria mund te priset para aftit te caktuar ne kete statut ne rast kur ndryshon afati ose kur ka nje prishje te parakoheshme per shkaqe te tjera



Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj .Per kryerjen e ketij procesi emerohen nje ose disa likujdatore te cilet ndjekin operacionet e likujdimit deri ne fund dhe I paraqesin Asamblese se ortakeve rezultatet perfundimtare te likujdimit . Ne perfundim Asambleja e ortakeve vendos per heqjen e mandatit te tyre . Te gjitha detyrimet qe dalin nga akti I likujdimit Asambleja e ortakeve I merr persiper per ti shlyer me kapitalin e ortakeve te shoqerise .

#### Neni 29

Te gjitha mosmarreshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim brenda shoqerise si dhe shoqeria me te tretet apo midis vete ortakeve do te zgjidhen nepermjet Gjykates se Shkalles se Pare Tirane , ku eshte edhe rregjistri tregetar I shoqerise .

#### Neni 30

Ceshtjet e tjera te patrajtuar ne kete statut do te mbeshteten per zbatim ne legjislacionin shqipetar ne fuqi , sipas rastit konkret , si ne ligjin 7512 date 10.08.1991, ligji 7638 date 19.11.1992, 7667 date 28.01.1993 dhe Kodit Civil si dhe akteve te tjera ligjore dhe nenligjore te dala ne zbatim te tyre .

#### Neni 31

Ndryshimi i formes se shoqerise ne nje shoqeri me forme tjeter behet me vendim te asamblese se ortakeve , kur plotesohen kushtet per krijimin e llojeve te tjera .

#### Neni 32

Asambleja e shoqerise mund te beje ndryshime e plotesime ne cdo kohe ne Statut e ne Kontraten e themelimit pa rene ndesh ne menyre thelbesore me nenet qe jane pershkruar ne kete statut .

Ndryshimet dhe plotesimet ne statut dhe ne kontraten e themelimit behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxirret vete statuti .

#### Neni 33

Shoqeria do te kete vulen e saj me madhesi te zakonshme e me tekst perreth saj .

#### Neni 34

Statuti eshte hartuar me vullnetin e lire dhe te plote te paleve , te dy ortakeve themelues , dhe eshte neshkruar prej tyre .

Statuti redaktohet ne kater kopie per tui shperndare organeve kopetente dhe nje kopie mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise .

Tirane, me 07.06.2006

#### ORTAKET THEMELUES

Eriola GIDAJA

Ardian TUFA

*Eriola Gidaja*  
*Ardian Tufta*

*[Signature]*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA TIRANE

Nr. 4008 Rep.  
Nr. — Kol.


VERTETIM

Vertetohet se sot me date 08.06.2006 ( dy mije e gjashte ) u paraqiten personalisht para meje Noteres Margena Cela me studio ne Tirane , Bul. Gjergj Fishta shtetasit si me poshte :

1. **Eriola GIDAJA** , e bija e Agronit , e dtl. 1984, lindur ne Tirane dhe banuese ne Mullet te Tiranes . Madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , me dokument identifikimi (pasaport) Nr. Z1261970 . Shtetase shqiptare .
2. **Ardian Tufa** , i biri i Isufit , i dtl.1971, lindur dhe banues ne Lunder te Tiranes, . Madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , me dokument identifikimi (pasaport) Nr. Z1675484 . Shtetas shqiptar .

te cilet nenshkruan para meje Noteres ( Akt - Themelimin dhe Statutin ) ne lidhje me regjistrimin e shoqerise " **NARI - LUNDRA** " Sh.p.k . Pasi u sigurova per identitetin e tyre dhe e gjeta dokumentin konforme ligjes , e nenshkruaj edhe une :

**NOTERE**



NOTERE  
MARGENA CELA  
CEL: 069 21 21 624